



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 të Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 12/19), neni 40 paragrafi 2 i Rregullores së punës së Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar në rastin e formuar pas kërkesës së paraqitur nga parashtruesi i njohur, Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejme KSHPK), në seancën e 81-të të mbajtur më 03.02.2023 ka miratuar si në vijim.

Vendim

Procedura me numër 12-3032/1, datë 07.06.2019, e formuarë pas një denoncimi anonim me pretendime për parregullsi të kryera nga zyrtarë të autorizuar në komunë ----- lidhur me ndërtimet pa leje objektet në vendbanimin. -----, NDËRPRIET.

KSHPK-ja konstatoi se, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, nuk ka elemente për veprime të mëtejshme lidhur me këtë çështje, sepse rasti në fjalë është trajtuar nga një autoritet tjetër kompetent, i cili ka kryer inspektim dhe ka marrë aktvendim nën juridiksionin e saj dhe po ashtu sipas të njëjtit denoncim është udhëhequr procedurë edhe para prokurorisë themelore publike.

Lënda me numër 12-3032/1 datë 07.06.2019 të mbyllet dhe arkivohet.

Vendimi duhet të publikohet në formë të depersonalizuar në faqen e internetit të Komisionit Shtetëror brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i tij.

Arsyetim

Me datë 07.06.2019, nga një parashtrues i panjohur është dorëzuar denoncim me numër 12-3032/1 të datës 07.06.2019, pas së cilës është formuar lënda me pretendime për parregullsi të kryera nga zyrtarët e autorizuar në Komunë ----- -- lidhur me objektet e ndërtuara pa leje në vendbanimin ----- . Në denoncim thuhet se objektet e ndërtuara pa leje – shtegë betoni që ka qenë afër banesave e cila ka ndikuar negativisht në mjedisin jetësorë dhe ajrin në vendbanimin në fjalë. Për rastin në fjalë nga parashtruesi janë njoftuar njësia e vetëqeverisjes vendore dhe Ministria e Transportit dhe Lidhjeve.

Me qëllim të konstatimit të gjendjes faktike për rastin konkret, KSHPK-ja ka paraqitur kërkesë dhe urgjencë në Komunën -----, për veprim kompetent nga inspektor të autorizuar ndërtimor dhe kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese sipas pretendimeve në fjalë. Me kërkesë të KSHPK-së janë dorëzuar të dhënat dhe informacionet e kërkuara, me dokumentacion bashkëngjitur dhe pas inspektimit të tyre është konstatuar:

- Komuna ka vepruar sipas kërkesë-denoncimit të paraqitur në formë të veçantë nga një grup anonim qytetarësh, të regjistruar në komunë ----- me numër -----/2 nga data 07.05.2019. Në bazë të kërkesës, në vendngjarje kanë dalë organet kompetente, inspektor i autorizuar ndërtimor dhe kanë përgatitur Procesverbal nga inspektimi i kryer me datë 16.05.2019 dhe në bazë të konstatimeve të gjendjes së konstatuar

gjatë mbikëqyrjes është marrë Vendim të regjistruar më datë 04.06.2019, me të cilin urdhëron investitorin, person fizik privat, të ndërpresë aktivitetet e mëtejshme në lidhje me kryerjen e veprimeve ndërtimore dhe brenda tre ditëve pas marrjes së vendimit për rivendosjen e vendndodhjes së specifikuar në gjendjen fillestare dhe të aplikojë për një leje ndërtimi.

- Nga ana e njësisë së inspeksionit të komunës ----- nga data 01.11.2019 është dërguar njoftim në PTHP. Prilep, lidhur me kërkesën e tyre të dorëzuar në Komunë, me të cilën kanë kërkuar të dhëna për rastin në fjalë. PTHP Prilep ka dorëzuar kërkesën në Komunë duke vepruar sipas denoncimit të dorëzuar nga një grup anonim i qytetarëve, kundër të njëjtit person fizik, investitor.

Bazuar në sa më sipër, KSHPK-ja ka konstatuar se lidhur me rastin në fjalë ka vepruar organi tjetër kompetent, i cili ka kryer inspektim dhe ka marrë vendim nën juridiksionin e tij, dhe në të njëjtën kohë është zhvilluar procedurë pranë prokurorisë themelore publike. Nga aty KSHPK-ja nuk ka elemente për veprime të më tutjeshme lidhur me këtë çështje dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI SHTETËRORE
PËR PARANDAËIMIN E KORRUPTIONIT**
Kryetare,
Biljana Ivanovska

Përgatiti: J.C,
miratoi: Mr. V.G, Anëtar i KSHPK-së

